

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 73/2021

**PËR SHTYRJEN E VOTIMIT PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR NGRITJEN
E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR TË KONTROLLUAR
LIGJSHMËRINË E VEPRIMEVE ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURËS
SË NDJEKUR NGA ANA E ORGANEVE EKZEKUTIVE NË PROCEDURAT
PËR NDËRTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË
MBETJEVE URBANE NË TIRANË, ELBASAN DHE FIER”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 49 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Shtyrjen e votimit për seancën pasardhëse të projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative dhe procedurës së ndjekur nga ana e organeve ekzekutive në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane në Tiranë, Elbasan dhe Fier”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

Miratuar në datën 14.10.2021